

TLAS




SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 / 2012

NUMRI TOTAL I CESHTJEVE NE VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2011



Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga UNDP

MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Av. Vangjel Kosta
Viktor Gumi
Av. Maksim Haxhia
Suzana Sakiqi
Shkelqim Bozgo

GRUPI KËSHILLIMOR

Av. Ardjana Fullani
Dr. Tefta Zaka
Av. Dashamir Kore
Av. Natasha Sheshi
Av. Perikli Zaharia

STAFI I TLAS

Dr. Rajmonda Bozo
Migen Elmazaj
Av. Adrian Shega
Dr. Elvira Dervishi
Av. Adnan Hoxha
Av. Anisa Metalla

“TË RRISIM AKSESIN NË SHËRBIMET DHE PROGRAMET SOCIALE TË INDIVIDËVE VULNERABËL NGA KOMUNITETI ROME”

UNDP ka qënë dhe mbetet një nga donatorët me aktiv në fushën e mbështetjes dhe fuqizimit të komunitetit Romë në disa rrethe të vendit si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Fieri. Viti 2011 shënon vitin e katërt të projekteve të zbtuara nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, me grante të siguruara nga UNDP. Synimi kryesor i këtyre projekteve është rritja e aksesit në drejtësi, që do të thotë rritja e aksesit në programet sociale të akorduara nga qeveria shqiptare, e familjeve vulnerabël nga komuniteti Rome.

Projekti një vjeçar që TLAS filloi të zbatojë në Korrik 2011 ka si **komponent të parë:** Sigurimin e shërbimeve ligjore për 170 individë kryefamiljarë burra ose gra nga komuniteti Rome në

Tirane, Durrës, Fier dhe Elbasan. Problematikat ligjore të komuniteteve të targetuara janë të ndryshme, sa të thjeshta në dukje, aq të komplikuar në realitet. Arsyet e ndërlikimit të tyre e kanë bazën së pari në mos ndjekjen e çështjes deri në fund, në kohën e duhur nga vet individët e familjeve Rome, së dyti nga indiferenca që shfaqet rëndom nga punonjësit e zyrave të pushtetit lokal për të orientuar apo zgjidhur kërkesën e paraqitur, së treti nga mosrespektimi i disa marrëdhënieve ligjore sic



janë martesat, transferimet, vecimet familjare, divorcet, regjistrimet e tjera të domosdoshme si punësimi, strehimi, etj. Deri tani janë përfaqësuar para administratës shtetërore dhe gjykatës keto raste:

Komponenti i dyte. është fokusuar në trainimin dhe ngritjen e



Regions	Me procedura Administrative	Me procedura gjyqësore
TIRANA	26	11
ELBASAN	57	20
DURRES	19	2
FIER	23	3
TOTAL :161	125	36



kapaciteteve të NGO've lokale në rajonet e targetuara për t'i aftësuar ato si të orientojnë dhe këshillojnë raste të thjeshta ligjore për zgjidhjen me pushtetin lokal. Dihet që organizatat Rome në këto rajone janë partnerë të rëndësishëm dhe të vlefshëm nëse angazhohen për të këshilluar e drejtuar familjet që

nuk janë në gjëndje të kërkojnë të drejtat që u takojnë.

Nr	Data	Vendi	Tema	Lloji i Aktiviteti	Në pjesmarrësve
1	11.11.2011	Tiranë	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë	Seminar me Punonjësit e ndihmës ekonomike	29
2	16.11.2011	Elbasan	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë	Seminar me organizatat komunitare	27
3	18.11.2011	Shkodër	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë	Seminar me Punonjësit e ndihmës ekonomike Seminar NGO	30
4	21.11.2011	Fier	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë	Seminar me organizatat komunitare	19
5	24.11.2011	Durrës	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në	Seminar me organizatat komunitare	27
6	14.12.2011	Tiranë	Fuqizimi i komuniteteve lokale në nevojë në	Seminar me organizatat komunitare	23

Komponenti i trete i projektit synon ndërgjegjesimin e anëtarëve të thjeshtë të komunitetit Rome për të marrë informacion rreth te drejtave ligjore që u takojnë dhe rrugën si të kërkojnë këto të drejta. Tabela e mëposhtme tregon realizimin e vizitave te grupit të studentëve ne zonat ku Romët jetojnë:



Data e vizitave ne komundet	Komuniteti	Nr. publikimeve te shperndara
16.09.2011	Fier	250
20.09.2011	Tirane	300
28.09.2011	Durres	250
17.10.2011	Fier	250
09.11.2011	Tirane	300
10.11.2011	Elbasan	250
18.11.2011	Shkoder	300
19.11.2011	Shkoder	300

Komponenti i katërt, ka të bëjë me një fushatë advokuese dhe lobuese për miratimin e disa akteve nën ligjore që mbështesin më tej regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar në zyrat e gjendjes civile në shkallë vendi sidomos të fëmijëve nga komuniteti Rome.

Si rezultat i një komunikimi të vazhdueshëm me Ministrinë e Brëndshme, Ministrinë e Jashtme dhe Ministrinë e Shëndetësisë u arritën të hartohen dhe të firmosen dokumenta shumë të rëndësishme që do të lehtësojnë në mënyrë të ndjeshme proceduarat e regjistrimit të fëmijëve dhe ato janë:

1.Udhëzimi Ministrisë së Punëve të Brëndshme, nr.7, datë 10.01.2012 " Për Miratimin e procedurës dhe procesverbalet që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së Shtetit dhe të Bashkive/ Komunave për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të patregjistruar në Gjëndjen Civile"



2. Urdhëri I Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 508, datë 07.12.2011, “ Për Miratimin e Certifikatës së Asistencës në Lindje”

3. Marrëveshja e Bashkëpunimit të TLAS me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar dhe të lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, nënshkruar në datën 16.11.2011

Sigurisht këto akte të përmendura më sipër po ndikojnë pozitivisht në reduktimin e numrit të fëmijëve të paregjistruar në Regjistrin Themeltar të Gjëndjes Civile. Ato janë dokumenta shumë të vlefshëm për zbatimin e procedurave të domodoshme me rugë administrative, të zbatuara si nga punonjësit e gjëndjes civile, ata të shëndetësisë, të Policisë së Shtetit, të ambasadave shqiptare jasht vendit ashtu edhe për organizatat me bazë komunitare apo ato të shoqërisë civile.

Raimonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS

REGJISTRIMI I FËMIJËVE NËPËRMJET PROCEDURËS PËR FËMIJËT E GJETUR

Fëmijët e paregjistruar kanë përbërë gjithnjë një problem sidomos në gjirin e komunitetit rom, të cilët për shkak të padijenisë së theksuar të ligjit dhe për shkak të neglizhencës e cila është edhe rrjedhojë e kushteve të vështira dhe problematikës në të cilat jetojnë dhe munden të ndërtojnë jetën e tyre anëtarët e këtij komuniteti.





Konsiderohet problematike pasi regjistrimi i një fëmije në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është si të thuash guri i parë mbi të cilin hidhen themelet e krijimit të jetës së një individi dhe projektimi i tij për të ardhmen. Por mbi të gjitha ky regjistrim, më shumë se është zanafilla e krijimit të një individi në kuptimin ligjor, mund të themi që është elementi bazik pa të cilin nuk mund të derivojë asnjë e drejtë tjetër që buron nga ligjet dhe nga politikat shtetërore. Një individ i paregjistruar është një individ i panjohur në kuptim të ligjit, është një individ i cili nuk

gëzon asnjë të drejtë, pasi edhe sipas Kodit Civil shqiptar "...që një individ të ketë zotësi juridike, duhet të vërtetohet lindja e tij gjallë...". Rrjedhimisht lindja e tij gjallë do të merret e mirëqenë vetëm nëpërmjet regjistrimit të tij në Regjistrin e Gjendjes Civile. Sipas ligjit Për Gjendjen Civile "Deklarimi i lindjes bëhet nga prindërit, pjestarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë apo kujdestarët. Dokumenti kryesor që vërteton lindjen e një fëmije është çertifikata e asistencës së lindjes e hartuar në momentin e lindjes dhe e nëshkruar nga personeli mjekësor i pranishëm në rastet kur lindja ka ndodhur në institucionet shëndetësore, ose procesverbali i nëshkruar nga kapiteni i anijes ose i avionit, drejtuesi i burgut apo i repartit ushtarak, organi i rendit publik apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike në mungesë të personelit mjekësor."

Megjithatë, përveç sa më sipër, jo në çdo rast kemi të bëjmë me lindje që ndodhin në institucionet shëndetësore në asistencë të personelit mjekësor të spe-

cializuar. Në praktikë ndodhin raste, sidomos në gjirin e komunitetit rom apo komunitetit që jeton në zona të thella rurale ku lindjet kanë ndodhur në kushtet e shtëpisë. Në raste të tilla ligji parashikon që “Në mungesë të dokumentacionit të përmendur më sipër, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.” Po ashtu rast që haset shpesh në praktikë është edhe dhënia nga ana e nënave të emrave apo mbiemrave të ndryshëm nga ai që kanë në realitet ose të mbiemrave të personave bashkëjetues në rastet kur nuk janë martuar. Kjo krijon problem në momentin e regjistrimit në gjendjen civile pasi nuk korespondon identiteti real i nënës me atë të reflektuar në certifikatën e asistencës së lindjes dhe për rrjedhojë i humbet fuqinë ligjore certifikatës së asistencës së lindjes. Në një rast të tillë do të ndodheshim përpara rrethanave të njëjta me ato në të cilat nuk kemi dokumentacion për të vërtetuar faktin e lindjes dhe për rrjedhojë, ashtu siç ligji parashikon do të kryhet

vërtetimi i faktit të lindjes nëpërmjet gjykatës.

Mirëpo gjatë punës së saj disa vjeçare në zyrën e TLAS janë paraqitur disa raste specifike të cilat nuk hyjnë në asnjë nga rastet që u përmendën më sipër për shkak të problematikës specifike dhe të veçantë që secili prej tyre paraqet.

Raste të tilla janë ato në të cilat fëmija është lindur nga nëna jashtë institucioneve shëndetësore dhe më pas është braktisur nga ajo duke ia lënë në kujdesje familjarëve të saj. Ekzistojnë po ashtu rastet në të cilat prindërit





kanë lindur fëmijë por janë larguar jashtë shtetit dhe nuk janë kthyer duke ia lënë fëmijët për kujdesje gjyshërve apo të afërmeve të tjerë. Lidhur me këto raste është hasur vështirësi në praktikë për regjistrimin e tyre pasi edhe ndjekja e rastit me rrugë gjyqësore krijon një ngërç për faktin e problemit lidhur me legjitimitimin e palës kërkuese në gjykim, të cilët në kushte normale duhet të jenë prindërit që kanë lindur fëmijët pasi gjatë gjykimit ndodh që lind edhe nevoja e kryerjes së analizave gjenetike të ADN-së për të përcaktuar dhe për të vërtetuar prindërit e fëmijës.

Duke u nisur nga kjo problematikë dhe duke marrë shkas nga vështirësia që kanë paraqitur në praktike rastet e sipërpërmendura, TLAS në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ka punuar që të zgjidhet në mënyrë eficiente kjo problematikë, që edhe në rastet kur regjistrimi i fëmijëve bëhet i pamundur për arsyet e përmendura më sipër, ai të mund të kryhet nëpërmjet procedurash më lehtësuese kryesisht administrative në bashkëpunim me përfaqësues të njërive të qeverisjes vendore apo të policisë së shtetit. Si rrjedhojë e një pune të përbashkët dhe një bashkëpunimi të frytshëm që është shoqëruar me një sërë takimesh dhe konsultimesh midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të TLAS, nga ana e Ministrisë së Brendshme u miratua më datë 10.01.2012 Udhëzimi "Për miratimin e procedurës dhe procesverbaleve për rastet e fëmijëve të gjetur dhe fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile":

UDHËZIM

Nr. 07 Date 10.01.2012

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE
TË PROCESVERBALEVE, QË DO
TË PLOTËSOHEN NGA PËRFAQË-
SUES TË POLICISË SË SHTETIT DHE
TË BASHKIVE/NJËSIVE BASHKI-
AKE/KOMUNAVE, PËR RASTET
E FËMIJËVE TË GJETUR DHE TË
FËMIJËVE TË PAREGJISTRUAR NË
GJENDJEN CIVILE

Në zbatim në nenit 102, pika
4 e Kushteutës së Reubublikës
së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9749,
datë 04.06.2007 "Për policinë e
shtetit", i ndryshuar, pikës 1,2,3,
të nenit 40, pikës 2 dhe 7 të ne-
nint 41 të ligjit nr. 10129, Datë
11.05.2009 "Për Gjendjen Civi-
le", me propozim të Drejtorisë së
Përgjithshme të Gjendjes Civile:

UDHËZOJ:

1. Përfaqësuesi i bashkisë/
njësisë bashkiake/komunës dhe
punonjësi i Policisë së Shtetit, të
cilët duhet të përcaktohen më

parë nga titullarët përkatës, kur
konstatojnë sipas rastit:

a. Fëmijë, të cilët janë të pa-
jjsur me "çertifikatën e asistencës
në lindje"/"procesverbalin e
hartuar në kohën e lindjes", por
që për shkaqe të ndryshme nuk
janë të regjistruar dhe nënat e
tyre i kanë lënë nën kujdesin e
të afërmeve;

b. Fëmijë të lindur dhe të
pajisur me dokumentacion, por
që nuk janë regjistruar në kohë
për arsye subjektive;

c. Fëmijë të gjetur, të pare-
gjistruar të cilët nuk janë të pa-
jjsur me dokumentacion, "çer-
tifikatën e asistencës së lindjes/
procesverbalin e hartuar në ko-
hën e lindjes";

Duhet, të hartojnë menjëherë
procesverbalin dhe të ndjekin
regjistrimin e fëmijës në zyrën
e gjendjes civile në juridksionin
territorial, të së cilës është gje-
tur/deklaruar si i paregjistruar
fëmija.

2. Përfaqësuesi i bashkisë/
njësisë bashkiake/komunës dhe
punonjësi i Policisë së Shtetit, që
kanë gjetur/konstatuar rastin,

bëjnë dokumentimin e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1/a, b, c, duke plotësuar përkatësisht formularët tip të miratuar.

3. Secili përfaqësues krijon dosjen përkatëse, në të cilën përfshihen:

- Kopja e procesverbalit;
- Asistenca e lindjes, apo çdo dokument që mund të disponojë i interesuari sipas rastit;
- Foto të çastit të gjetjes së fëmijës;

4. Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, si dhe pala e interesuar nëse ka, së bashku me fëmijën, paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile për të bërë deklarinimin e lindjes së fëmijës pas plotësimit të praktikave, sipas përcaktimeve në pikën 1:

a. Për rastin e përcaktuar në pikën 1.a., do të plotësohet procesverbali Mod. 1, të cilit i bashkëlidhet "çertifikata e asistencës në lindje:/"procesverbali i hartuar në kohën e lindjes", që disponojnë të afërmit e fëmijës;

b. Për rastin e përcaktuar në pikën 1.b., do të plotësohet

procesverbali Mod. 2, të cilit i bashkëlidhet "çertifikata e asistencës në lindje";

c. Për rastin e përcaktuar në pikën 1.c., të këtij udhëzimi do të plotësohen procesverbali Mod. 3, të cilit i bashkëlidhet "raporti mjekësor", i plotësuar nga mjeku i zonës ku është gjendur fëmija;

5. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, zbaton rast pas rasti të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", për këto kategori fëmijësh dhe për çdo akt të mbajtur njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Kryetarët e Bashkive/Njësisë Bashkiake/Komunave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi dhe me komunikimin e tij e vënien në dijeni të personave që do të merreshin konkretisht me rastet pranë njësive të qeverisjes vendore apo punonjësve të policisë së shtetit, mundi të niste edhe nga ana e TLAS puna për ndërmarrjen e procedurave që përcakton udhëzimi me qëllim kryerjen e regjistrimeve të fëmijëve me anë të procedurës së sipërpërmendur për ato raste të cilat ishin të kategorizuara nga vlerësimi i bërë si raste të cilat mund të regjistroheshin nëpërmjet procedurës së mësipërme.

Klientja e zyrës me inicialet SH.R. është gjyshja e fëmijës e cila e kishte rritur që në moshë të vogël. Fëmija kishte lindur nga bashkëjetesa e djalit të klientes me nënën e fëmijës. Menjëherë pas lindjes, nëna e fëmijës dhe djali i klientes sonë ishin larguar jashtë shtetit dhe fëmijën ia kishin lënë nënës së tyre e cila ishte kujdesur për fëmijën deri sa fëmija ishte bërë 8 vjeç. Duke qenë se fëmija kishte lindur jashtë institucioneve shën-



detësore dhe nuk kishte pasur asnjë dokument për vërtetimin e lindjes së saj, kishte qenë e pamundur regjistrimi i fëmijës si në mënyrë administrative ashtu edhe mundësia për të kryer një procedurë gjyqësore për vërtetimin e lindjes së këtij fëmije për vetë specifikat që paraqiste ky rast për faktin se asnjë dokument nuk disponohej për lindjen e tij dhe se asnjë nga prindërit nuk ndodhej që të mund të niste procedurat për vërtetimin gjyqësor të lindjes. Ky rast ishte kategorizuar në ato raste të cilat mund të zgjidheshin nëpër-



mjet procedurës për regjistrimin e fëmijës me anë të procedurës së miratuar nëpërmjet udhëzimit të mësipërm.

Fillimisht nga ana e avokatëve të TLAS u komunikua me personat përgjegjës pranë njësisë së qeverisjes vendore dhe policisë së shtetit lidhur me dijeninë për Udhëzimin e Ministrisë duke qenë se ishte një udhëzim i dalë rishtazi dhe kishte nevojë për diskutim dhe për tu kuptuar realizimi dhe zbatimi në praktikë i regjistrimeve nëpërmjet kësaj procedure. Duke qenë se fëmija kishte lindur jashtë institu-

cioneve shëndetësore, atëherë regjistrimi i tij do të bëhej i mundur të kryhej sipas pikës 1 c. të udhëzimit sipas të cilit "Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashki-ake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, të cilët duhet të përcaktohen më parë nga titullarët përkatës duhet, të hartojnë menjëherë procesverbalin dhe të ndjekin regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile në juridksionin territorial, të së cilës është gjetur/deklaruar si i paregjistruar fëmija kur konstatojnë sipas rastit fëmijë të gjetur, të paregjistruar të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacion, "çertifikatën e asistencës së lindjes/procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes".

Nga ana e avokatëve të TLAS u bë e mundur sigurimi i dokumentave shëndetësorë për fëmijën, u krye realizimi i fotografive për fëmijën dhe u hartua procesverballi nga ana e përfaqësuesit të njësisë së qeverisjes vendore dhe përfaqësuesit të policisë së shtetit duke u plotësuar dhe nënshkruar nga palët. Të gjitha këto dokumente ashtu siç për-

cakton edhe udhëzimi të cilët përbëjnë atë që quhet “dosja përkatëse e regjistrimit e cila duhet të përmbajë kopje të procesverbalit, asistencë e lindjes, apo çdo dokument që mund të disponojë i interesuari sipas rastit, foto të çastit të gjetjes së fëmijës” u paraqitën para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile për të bërë deklarin e lindjes së fëmijës pas plotësimit të praktikave të mësipërme nga përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, si dhe pala e interesuar së bashku me fëmijën.

Nëpërmjet kësaj procedure u krye me sukses regjistrimi i fëmijës në regjistrin e gjendjes civile. Tashmë ky fëmijë figuron si një individ apo një person i lindur gjallë dhe i regjistruar si i tillë në kuptim të ligjit, i cili gëzon zotësi juridike për të pasur të drejta të cilat i atribuohen nga ligji apo nga politikat sociale, arsimore e shëndetësore shtetërore.

Mbas kryerjes së regjistrimit ashtu siç parashikon edhe Udhëzimi në modelet e formularëve,

nga ana e palës së interesuar mund të kërkohet sipas rastit në Gjykatë kujdestaria mbi të miturin apo përkatësisht njohja e amësisë apo atësisë.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS



REGJISTRIMI I FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË SHETIT

Gjatë punës së përditshme, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ka hasur shumë raste të fëmijëve të paregjistruar, të lindur jashtë shtetit. Këta fëmijë nuk janë regjistruar nga prindërit e tyre, për shkak se kanë patur mangësi në dokumentacion. Për plotësimin e dokumentacionit është dashur që ata të shkojnë përsëri në vendet e lindjes së fëmijëve jashtë shtetit dhe të

marrin dokumenta shtesë, apo të bëjnë vërtetime të dokumentave tek autoritetet e huaja, apo të bëjnë legalizimin e tyre në konsullatat shqiptare.

Rastet e familjeve të ndjekura nga TLAS, janë familje me shumë pak të ardhura dhe që nuk kanë mundësi financiare, as njohuritë e duhura për të përballuar shpenzimet e udhëtimit dhe procedurat e pajisjes me dokumentat e fëmijëve të tyre të lindur jashtë shtetit. Duke parë se numri i fëmijëve të lindur jashtë shtetit, që nuk janë regjistruar në gjendjen civile, për shkak të mangësisë së dokumentacionit, është i konsiderueshëm, TLAS mendoi që të gjente një rrugë institucionale, për ndjekjen dhe zgjidhjen e tyre. Për këtë arsye, u mendua që të realizohej një bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, që do të ndihmonte në përfshirjen e konsullatave shqiptare, në plotësimin e dokumentacionit të lindjeve të fëmijëve.

Mbas disa takimesh dhe kon-



sultash, u arrit të hartohej një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Ligjor Falas Tiranë. Në bazë të këtij Memorandumi, MPJ dhe TLAS angazhohen që të ndjekin rastet e fëmijëve të lindur jashtë shtetit, duke siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë.

Katër muaj mbas firmosjes së Memorandumit, mund të themi që ka patur një bashkëpunim shumë të mirë dhe është realizuar një numur i madh regjistrimesh të lindjeve të fëmijëve. Ky bashkëpunim ka qënë kryesisht për fëmijët e lindur në Greqi, që përbëjnë edhe shumicën dërmuese të fëmijëve të lindur jashtë shtetit. Ambasada shqiptare në Athinë i është përgjigjur brënda një kohe shumë të shkurtër të gjitha kërkesave për plotësim dhe legalizim dokumentacioni, duke mundësuar kështu, realizimin e regjistrimit të një numri të madh fëmijësh të paregjistruar.

Por duhet të themi që jo çdo gjë

ecën pa pengesa. Ka raste kur maternitetet kthejnë përgjigje negative në ambasada, duke mos pranuar të japin informacion me shkrim për të dhënat e lindjes së fëmijëve, duke mbyllur kështu burimin e vetëm të informacionit. Për këto raste del si detyrë që ambasadat të vazhdojnë punën me autoritetet më të larta përgjegjëse.

ELVIRA DERVISHI **Këshilltare Programi**



**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET MINISTRIË SË PU-
NËVE TË JASHTME DHE QENDRËS
“SHËRBIMI LIGJOR FALAS”**

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë (MPJ), dhe Qendra “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS),

Me qëllim bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit;

Në respektim të Ligjit nr.8372, date, 09. 07. 1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”;

Duke patur parasysh se TLAS ka si mision kryesor ofrimin e shërbimeve ligjore falas për shtresat në nevojë dhe rritjen e aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël;

Bien dakord si më poshtë:

Neni 1

MPJ shprehet e gatshme të bashkëpunojë me TLAS, në për-

puthje me legjislacionin shqiptar, për nxitjen dhe asistencën e regjistrimit të fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk janë regjistruar ende në zyrat shqiptare të gjendjes civile.

Neni 2

MPJ i kërkon TLAS që të asistojë familjet në nevojë për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar në regjistrat e gjendjes civile, kur konstaton nëpërmjet konsullatave jashtë vendit për raste të tilla.

MPJ i përcjell TLAS të dhënat që disponon për rastet e konstatuara prej saj të fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë territorit të RSH-së dhe të paregjistruar në gjendjen civile.

Këto të dhëna disponohen vetëm nga TLAS në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nuk mund të transferohen apo tjetërsohen nga asnjë individ apo organizëm tjetër.

Shpenzimet e nevojshme për sigurimin e dokumentacionit të kërkuar për raste të tilla mbulohen nga TLAS.

Neni 3

TLAS i paraqet MPJ rastet e konstatuara prej saj të fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të paregjistruar në gjendjen civile.

MPJ angazhohet nëpërmjet përfaqësive konsullore që mbulojnë rrethin e juridiksionit në të cilin ka lindur fëmija, të kërkojë pranë autoriteteve përkatëse dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e fëmijëve.

MPJ i përcjell TLAS të dhënat që disponon për këto raste në përputhje me parashikimet e ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale". TLAS administron në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera në fuqi të dhënat e marra nga MPJ.

TLAS asiston familjet për regjistrimin e fëmijëve pranë zyrave të gjendjes civile pa pagesë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Memorandumi mirëkuptimi ndërmjet MPJ dhe TLAS do të respektohet legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Bërë në Tiranë, më 16.11.2011

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Selim BELORTAJA
Zëvëndësministër

Për Shërbimin Ligjor Falas Tiranë.

Raimonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS

Histori e Vërtetë

G. është një vajzë e vogël, 7 vjeçare që jeton me babain e saj A.P. Ajo është e peregjistruar në gjëndjen civile. Për këtë arsye, ajo nuk është as në shkollë. Mbas lindjes së vajzës, nëna e saj H.T. u largua nga shtëpia dhe për shumë vite ka jetuar jashtë shtetit. Aktualisht, ajo po shlyen një dënim me burgim në Tiranë. A.P. dhe H.T. nuk kanë patur martesë ligjore dhe vajza ka lindur gjatë bashkëjetesës së tyre të shkurtër. Nëna H.T. e ka

gjëndjen civile në bashkinë e Rr, ndërsa babai A.P. e ka gjëndjen civile në Tiranë. Që mbas lindjes së fëmijës dhe largimit të nënës nga shtëpia, prindërit e G. nuk kanë patur asnjë lloj marrëdhënie midis tyre. Gjatë kohës që H.T. vuan dënimin me burgim, babai A.P. e ka dërguar herë pas here vajzën në takime me nënën e saj.

Mbas disa takimeve me personelin e TLAS, A.P. u angazhua seriozisht për të ndjekur procedurat e regjistrimit të vajzës së tij në gjëndjen civile. U konstatua fillimisht që nëna H.T. nuk kishte asnjë lloj dokumenti identifikimi, kështu që ishte e nevojshme fillimisht pajisja e saj me letërnjoftim. TLAS u kujdes që nëna të pajisej me kuponin e posaçëm dhe të vazhdonte me procedurat e aplikimit për t'u pajisur me letërnjoftim. Mbas pajisjes së nënës me dokument identifikimi dhe mbas disa takimesh me autoritetet e burgut, u arrit që të bëhej shoqërimi i nënës në zyrën e gjëndjes civile në Tiranë, ku është i regjistruar babai i vajzës



A.P., për të bërë raportimin e lindjes nga ana e nënës. Babai A.P. kishte çertifikatën origjinale të asistencës në lindje të vajzës, të lëshuar nga materniteti. Çertifikata ishte e rregullt. Nëna kishte raportuar emrin dhe mbiemrin e saj të saktë, ashtu siç është e regjistruar në gjëndjen civile.

Gjatë mbajtjes së aktit të lindjes, ishte i pranishëm edhe babai i vajzës A.P. Nëna bëri edhe njohjen e atësisë së fëmijës, duke mundësuar që fëmija të merrte mbiemrin e babait të saj. Kësh-tu, përfundimisht fëmija G.P. mund të kishte çertifikatën e saj, si të gjithë moshatarët e saj. Tani nuk do të kishte asnjë pengesë që ajo të vazhdonte rregullisht shkollën.

Gjatë procedurës së mbajtjes së aktit të lindjes, babai shfaqti dëshirën që fëmija të hidhej në fletën e tij familjare, meqë ai ishte kujdesur për të që nga lindja dhe mendonte që fëmija do të vazhdonte të ishte ende nën kujdesin e mëtejshëm të tij. Nëna H.T. nuk e pranoi këtë

kërkesë dhe fëmija u regjistrua si pjestare e familjes së nënës H.T. Kuptohet që babai nuk ishte dakort me këtë zgjidhje dhe për këtë ai i kërkoj TLAS që ta mbështeste më tej, në marrjen e fëmijës në fletën e tij familjare, nëpërmjet një procesi gjyqësor. TLAS do të shqyrtojë ndjekjen e mëtejshme të rastit, duke u mbështetur në interesin më të mirë të fëmijës.

ELVIRA DERVISHI **Këshilltare Programi**



LEGJISLACIONI I PUNËSIMIT

Ligji për Punësimin në Republikën e Shqipërisë parashikon disa kategori punësimi.

Kush mund të përfitojë nga legjislacioni i punësimit?

Fillimisht duhet të sqarojmë se çfarë do të kuptojmë me person i papunë dhe me termin person punëkërkues.

Me termin “person i papunë” nënkuptohet personi që është shtetas i Republikës së Shqipërisë, që është në moshë

pune, nuk punon dhe nuk ushtron aktivitet si i vetëpunësuar.

Me termin “punëkërkues”, nënkuptohet çdo person i papunë, i disponueshëm për punësim, i cili paraqitet periodikisht në zyrën përkatëse të punësimit. Të tillë konsiderohen dhe personat të cilët janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, por që kërkojnë një punë të re.

Në legjislacionin aktual të punësimit egziston një program i veçantë në lidhje me tregun e punës.

Programet e tregut të punës ndahen në tre grupe:

- a. Shërbimet e Punësimit
- b. Programet e krijimit të vendeve të reja të punës
- c. Programet e formimit profesional

Një ndër programet më të rëndësishme të tregut të punës janë shërbimet e punësimit.

Shërbimet e punësimit përfshijnë veprimtari të:



- informimit mbi vëndet e lira të punës;
 - ndërmjetësime për punësim;
 - këshillim dhe orientim për punë dhe profesion
 - Shërbimi Kombëtar i Punësimit garanton pa pagesë ndërmjetësim për punë për punëdhënësit dhe punëkërkuessit në tërë territorin e vendit
- Shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vënde të reja pune dhe punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit

Pjesë e rëndësishme e ligjit janë edhe programet e formimit profesional.

Punëkërkuessit të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm/e lartë brenda ose jashtë vendit marrin pjesë në programe praktikash profesionale (stazhe). Institucionet publike e ofrojnë këtë shërbim falas.

Formimi profesional u shërben si punëkërkuessve edhe punëdhënëssve dhe realizohet nëpërmjet kurseve të mësimi teoriko-praktik dhe pjesëmarrjes në proçese të posaçme pune.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit zbaton programet shtetërore për formimin profesional dhe ofron:

- kurse pa pagesë për punëkërkuess të papunë që trajtohen nga zyrat e punësimit;
- kurse me pagesë për personat që e kërkojnë një gjë të tillë
- mjedise dhe mjete llogjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.

Personat e papunësuar, të cilët janë regjistruar për punë pranë zyrës kompetente të punësimit





rregullat që duhet të ndjekin gjatë kësaj periudhe që atyre i ofrohet ky shërbim. Në ligj është parashikuar se:

Çdo person që kërkon punë ose punë të re, mund të drejtohet për punë dhe për përgatitje për punë në Zyrën Kombëtare të Punësimit ose, me lejen e saj, dhe në ndonjë zyrë tjetër punësimi. Me anën e zyrës kompetente të punësimit, ai mund të regjistrohet për të marrë ndihmën që i takon.

dhe kanë pranuar të marrin pjesë në formimin profesional të siguruar nga Shërbimi Kombëtar i Punës, marrin një pagesë pjesëmarrje në kurs që përcaktohet nga ministria, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë

Gjithashtu legjislacioni parashikon një procedurë dhe rregulla të caktuara për personat që duan të regjistrohen si punëkërkues të papunë dhe

Personat, që për shkak të papunësisë ose të varfërisë, kërkojnë të përfitojnë nga programet shtetërore të mbështetjes në të ardhura, duhet që në çdo rast, të vërtetojnë nga zyra kompetente e punësimit për gjëndjen e tyre si të papunë.

Zyra kompetente e punësimit vërteton të qëniet e punësuar, të papunë ose punëkërkues të papunë për vetë personin ose organizmin shtetëror, të interesuar për këtë.

Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si të pa-


punë çdo person i cili paraqitet pranë saj, deklaroi se nuk është në marrëdhënie pune, nuk është i vetëpunësuar dhe që depoziton pranë saj librezën e punësimit.

Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si punëkërkues të papunë çdo person të papunë, i cili kërkon punë dhe është i gatshëm të paraqitet sa herë që i kërkohet një gjë e tillë. Një pretendues mund të vlerësohet si punëkërkues i papunë të paktën një muaj kalendarak pas ditës së paraqitjes së tij të parë në zyrën kompetente të punësimit për këtë qëllim.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me kartë personale papunësie tërë personat që pranojnë një gjë të tillë. Në kartën e papunësisë bëhet vërtetimi nga zyra kompetente e punësimit e të qenit punëkërkues i papunë i mbajtësit të kartës. Pajisja me kartë papunësie bëhet kundrejt depozitimit në zyrën kompetente të punësimit të librezës së punësimit

Personat, të cilët kundërshtojnë vënde pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore, të ofruara nga zyra përkatëse e punësimit, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë

DETYRIMI PËR USHQIM PËR FËMIJËT E LINDUR JASHTË MARTESE

Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente me initiale A.F, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar pension ushqimor për djalin e saj të mitur të lindur jashtë martese, pasi babai i fëmijës pavarësisht se e kishte njohur atësinë e fëmijës nuk pranonte të kontribuonte në mirëritjen e fëmijës.



Janë pikërisht këto raste të cilat po shtohen dita ditës në shoqërinë Shqipëtare, pasi siç dihet është rritur mjaft numri i martesave të faktit (martesa jo në kuptimin ligjor, bashkjetesë), dhe janë pikërisht këto probleme që hasen pas ndërprerjes së bashkëjetesës. Pasi fëmija jeton me njërin nga prindërit dhe fakti se fëmija nuk jeton me prindin tjetër nuk e shkarkon atë nga detyrimi për të kontribuar për një jetesë më të mirë të fëmijës së tij.

U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm të cilat vërtetonin faktin që fëmija jetonte me nënën dhe të gjithë dokumentat që u konsideruan të nevojshëm për fillimin e procesit gjyqësor.

U mendua që të hartohej një kërkesë padi duke u thirrur si i paditur në gjykim i ati i fëmijës. Vetë termi bashkjetesë është shume i perdorur këto vitet e fundit por sipas nenit 163 të Kodit të Familjes :“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas qe jetojnë ne çift, e karakterizuar nga një jete e përbash-

kët, qe paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie".

Për fëmijët e lindur jashtë martesë neni 170 i Kodit të Familjes parashikon: "Amësia dhe atësia e fëmijës se lindur jashtë martesë mund te vendosen me ane te njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon te drejta dhe detyrime te njëjta, ne mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesë". Pra nga neni i mesipër kuptohet qartë se edhe fëmijët që janë fryt i bashkjetesës gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur nga martesë dhe prindërit e tyre kanë të njëjtat detyrime njësoj si për fëmijët e lindur nga martesë.

Sipas nenit 192 pika "b" e Kodit të Familjes "Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijës së tyre", pavarësisht nëse fëmija ka lindur jashtë martesë apo nga martesë, madje nei 196 përmend faktin se edhe në qoftë se njërit nga prindërit i është hequr përgjegjësia prindërore, përsëri ai nuk mund ti shmanget detyrimit për ushqim ndaj fëmijës së tij.

Neni 197 prashikon "Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve te tyre, kur këta nuk kanë mjete te mjaftueshme për te jetuar.

Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve te tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur te ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.

Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohen qe fëmijët madhore ndjekin shkollën e mesme ose te larte, deri ne moshën njëzetepesë vjeç".

Pra duke iu rikthyer rasit të klientes K.N, duke marrë parasysh



moshën e mitur të djalit të saj dhe vështirësinë financiare në të cilën ajo ndodhej, ajo në bazë të të gjithë neneve të përmendur më lart përligjej plotësisht në kërkimin e saj, duke kërkuar një jetë më të mirë për fëmijën e saj. U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seance gjyqësore dhe gjykata arritti në përfundimin se klientja A.F kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i lidhur në këtë mënyrë një pension fëmijës së klintes A.F.

Në këtë mënyrë ky fëmijë do të ketë një të ardhme më të mirë dhe do të ketë mundësi më të mëdha për të pasur një jetesë normale njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Mbas një pune pothuajse 2 vjecare duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klientja A.F.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë

Në zyrën e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë u paraqitën rastet e një grupi klientësh në kuadër të projektit të UNDP.

Këto klientë i përkisnin të gjithë komunitetit Rrom dhe të gjithë i lidhte një problematikë.

Fillimisht avokatët e TLAS u takuan më këtë komunitet në banesat e tyre jashtë rrethit të Tiranës. Në këtë takim u konstatua nga pohimet e vetë personave se ata kishin humbur shtetësinë shqiptare dhe nuk gëzonin shtetësinë e asnjë vendi tjetër. Ata pretendonin se nuk kishin bërë asnjëherë kërkesë për lënien e shtetësisë shqiptare por u kujtohej se për një gjë të tillë kishte aplikuar shumë vite më parë një i afërm i tyre. Disa prej tyre kishin karta identiteti gjë e cila e bënte të vështirë të besohet se kishim të bënim me humbjen e shtetësisë shqiptare. Këta persona nuk dispononin asnjë dokument, (në rastin në fjalë do të ishte i nevojshëm një dekret që legjitimonte heqjen e shtetësisë) përveç disa dokumentave personale identifikuese

të vjetra në kohë.

Nga takimi i parë u kuptua që ishte e nevojshme të bëhëj një verifikim lidhur me këta persona në zyrën përkatëse të gjendjes civile apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga Zyra e Gjendjes Civile e zonës konstatuam se këta shtetas nuk figuronin në regjistrin kombëtar të gjendjes civile, pra u kuptua që këta persona nuk figuronin si shtetas shqiptarë. Për këtë arsye u kërkua informacion nëpërmjet një shkrese drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile lidhur me numrin





dhe vitin e Dekretit që kishte vendosur heqjen e shtetësisë. Nga ky institucion na u kthye përgjigje për atë që kërkonim, pra u identifikua heqja e shtetësisë me dekretin përkatës dhe na u dërgua lista emërore e të gjithë personave që nuk kishin më shtetësinë. Bëhej fjalë për një grup prej 20 personash. Ajo që të binte në sy ishte fakti që këtyre personave ju ishte hequr shtetësia shqiptare që në vitin 1994 dhe një gjë e tillë ishte identifikuar vetëm disa muaj përpara referimit të këtyre rasteve në zyrën tonë. Edhe në Zyrën e Gjendjes Civile të Zonës shkresa që njoftonte për shtetësitë e hum-

bura të klientëve ishte e kohëve të fundit, disa kohë përpara krijimit të regjistrit elektronik të Gjendjes Civile.

Mirëpo kjo situatë i kishte privuar gjatë gjithë kësaj kohë këta persona të përfitonin nga shërbimet sociale shtetërore, të përfitonin nga skema e ndihmës ekonomike, të regjistroheshin si të papunë apo të përfitonin nga shërbimet shoqërore e shëndetsore. Këta persona i përkisnin një shtrese mjaft në nevojë të shoqërisë të cilit e kishin të domosdoshme asistencën e këtyre shërbimeve, majde njëri prej klientëve kishte paaftësi të plotë mendore dhe si pasojë nuk mund të merte pagesë paaftësie dhe as të kryente ekzaminimet e nevojshme mjekesore.

Pas konstatimit të fakteve të mësipërme u fillua nga puna për zgjidhjen e problemit të klientëve.

Hapësira ligjore në të cilën ishte kërkuar dhe legjitimuar lënia e shtetësisë së klientëve i ishte nënshtruar ligjit të kohës. Ligji në fuqi është ligji nr. 8389 datë 5.8.1998 "Për Shtetësinë Shqiptare" i ndryshuar. Ky ligj ndër të tjera parashikon:

“...shtetasi shqiptar mund të jete edhe shtetas i një shteti tjetër...”.

Neni 17

“..Askujt nuk mund t'i hiqet arbirarisht shtetësia shqiptare...”.

“..Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare me kusht që të ketë një shtetësi tjetër, të ketë fituar një shtetësi tjetër apo t'i jetë garantuar nga organet kompetente të shtetit të huaj dhënia e një shtetësie tjetër...”

Nga një vështrim i përgjithshëm i ligjit ishte e qarte se kishim të bënim me persona pa shtetësi, pra që nuk kishin as shtetësinë shqiptare dhe as nuk kishin fituar asnjë shtetësi tjetër.

Cdo shtet demokratik duhet të zbatojë marrëveshjet ndërkombëtare për reduktimin e pashtetësisë. Në këtë rast kishim të bënim pikërisht me një situatë të tillë e cila jo vetëm nuk ishte marrë në konsideratë por gjithashtu kishte vite të tëra e cila nuk ishte konstatuar. Ligji shqiptar parashikon rifitimin e shtetësisë shqiptare sipas procedurave të mëposhteme:

Kërkesa për fitimin, rifitimin ose heqjen dorë nga shtetësia shqiptare paraqitet në organet e Ministrisë së Rendit Publik të vendbanimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, në përfaqësitë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. e shoqëruar me dokumentet e kërkuara nga ky ligj.



Neni 18

Në rast se dokumentet e nevojshme nuk janë të plota, organet kompetente, brenda një muaji, ia kthejnë kërkuessit për plotësime të mëtejshme.

Neni 19

Ministria e Rendit Publik brenda 6 muajve nga dita e paraqitjes së kërkesës së individit, në baze të kushteve të përcaktuara në kete ligj për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare, vendos

për paraqitjen ose jo të kërkesës për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë pranë Presidentit të Republikës.

Kërkesa e Ministrisë së Rendit Publik shoqërohet me dosjen e plote individuale të kërkuessit.

Vendimi për bërijen ose jo të kërkesës nga ana e Ministrisë së Rendit Publik i behet e njohur subjekteve të interesuara, të cilat, në rast se nuk janë dakord me përmbajtjen e tij, mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 20

Presidenti i Republikës, brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës së Ministrisë së Rendit Publik, nxjerr dekretin përkatës. Në rast se kërkesa nuk është e plotë, materiali i kthehet për t'u plotësuar Ministrisë së Rendit Publik brenda 1 muaji nga dita e paraqitjes.

Kur janë kushtet e pikës 7 të nenit 9 të këtij ligji, dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nxirret edhe pa ndjekur procedurën e mësipërme.



Referuar akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Parashikohet se dokumentat të cilat duhet të shoqërojnë kërkesën për rifitim të shtetësisë shqiptare janë:

- *Kerkesa e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës.*

- *Çertifikate lindje dhe familjare;*

- *Relacion shpiegues dhe konfirmimi nga komisiari i policisë vendore dhe prefektura përkatëse lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë patur prindërit e çdo aplikanti. (përpilohet nga sektori i policisë kriminale dhe Prefektura e qarkut)*

- *Deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër.*

- *Vertetimin e njësive administrative përkatëse për çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç.*

- *Çertifikatë lindje ose të vdekjes të prindërve të çdo aplikanti.*

- *Fotografi e aplikantit, copë 3 tre (në rast se ka fëmijë nën moshë 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).*

- *Mandat pagesa për aplikimin.*

Pra, sikurëse vihet re, ishte e nevojshme që të përpiloheshin një numër i madh dokumentash për të gjithë personat, duke patur parasysh edhe faktin e mbulimit të shpenzimeve për çdo dokument. Nga avokatët e TLAS fillimisht u fillua me përgatitjen e dokumentave nga Zyra e Gjendjes civile (çertifikatat e kërkuara për çdo aplikant) për të cilat u kërkuar një kohë e gjatë pasi çertifikatat nuk mund të printoheshin nga sistemi elektronik i regjistrit të gjendjes ci-



vile sepse personat nuk ishin të regjistruar, si pasojë duhej të nxirreshin të dhënat në mënyrë manuale nga arkivat e regjistrave të Gjendjes Civile.

Më pas u proçedua me dokumentat e tjera të kërkuara nga zyra e Gjendjes civile.

Më vështirësi u realizuan deklaratat noteriale për klientët të cilët nuk dinin të shkruanin dhe ishte e nevojshme të paraqiteshin të gjithë personalisht për hartimin e tyre. Kjo gje gjithashtu u realizua me sukses.

Pas mbledhjes së të gjithë dokumentave u bë aplikimi i klientëve

për rifitimin e shtetësisë shqiptare të clët u përfaqësuan nga avokatët e TLAS.

Nga aplikimi, sikurëse mund të shikohet nga parashikimi ligjor cituar më sipër, nevojitet një periudhë disa mujore derisa institucionet përkatëse të bëjnë verifikimet dhe vlerësimet e duhura e më pas kërkesa të përcillet në Presidencë. Më pas është Presidenti i Republikës i cili shprehet lidhur me kërkesën për rifitimin e shtetësisë shqiptare.

Avokatët e TLAS janë në kontakt të vazhdueshëm me këto institucione në mënyrë që lidhur me çështjen të mos ketë vonesa të paarsyeshme dhe që klientëve t'ju kthehet sa më parë shtetësia shqiptare.

Anisa Metalla
Avokate/ Keshillare Paraligjore
TLAS



LIGJ
Nr.10 447, datë 14.7.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993

“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paragrafi i katërt shfuqizohet.
2. Paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

“Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprorë caktohen me këtë ligj.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me rregullore të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.”.

Neni 2

Pas nenit 39 shtohen nenet 39/1, 39/2, 39/3 dhe 39/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 39/1

Ankimi në Komisionin Epror

1. Kundër vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë Komisioni Epror).

2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.

Neni 39/2 **Përbërja e Komisioneve Eprorë**

1. Komisionet Eprorë përbëhen nga 5 anëtarë secili, të cilët zgjidhen në detyrë me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministrat propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtar i pestë i Komisionit Epror propozohet nga Ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore.

3. Anëtar i Komisionit Epror mund të emërohet shtetasi që përmbush këto kriterë:

- a) të jetë me gradë shkencore "Profesor", "Profesor i asociuar" ose "Doktor shkencash";
- b) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë në fushën e vet të ekspertizës;
- c) të mos jetë i dënueshëm penalisht;
- ç) të ketë një figurë të pastër morale.

4. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Eprorë, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/3 **Mandati i anëtarit të Komisionit Epror**

1. Anëtar i Komisionit Epror ka mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Anëtar i Komisionit Epror e ushtron këtë detyrë me kohë jo të plotë.

3. Anëtar i Komisionit Epror e ushtron funksionin në mënyrë të parvarur dhe në përputhje me bindjen e tij profesionale.

4. Përpara fillimit të detyrës, anëtar i Komisionit Epror kryen betimin në një ceremoni publike, të organizuar nga Ministri i Financave, ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe ministri që mbulon fushën e çështjeve sociale.

5. Teksti i betimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/4

Mbarimi para kohe i mandatit

1. Mandati i anëtarit të Komisionit Epror mbaron para kohe kur:

a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) nuk paraqitet, pa arsye, në detyrë për më shumë se dy mbledhje radhazi;

c) jep dorëheqjen;

ç) deklarohet i paafë me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Anëtari i Komisionit Epror shkakohet nga Këshilli i Ministrave:

a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo akteve të tjera ligjore;

b) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash.

3. Në rast se vendi i anëtarit të Komisionit Epror mbetet vakant, ai zëvendësohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 39/2 të këtij ligji, pas 15 ditëve nga çasti i krijimit të vakancës dhe qëndron në detyrë deri në përfundimin e afatit të anëtarit që ka zëvendësuar.”.

Neni 3

Nxjerja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 39/1, 39/2 dhe 39/3 të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7062, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

Lënda: Dhënie mendimi ligjor lidhur me projektvendimi “Për zbatimin e ligjit nr. 10 447, datë 14.7.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

Qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi, është përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i datës 03.02.2009 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” (ankesa nr. 19206/05),



në zbatim të cilit u miratua dhe ndryshimet e Ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” është shprehur se është e nevojshme të përcaktohet nëse komisioni i ankimeve përbën një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë konsiderohet e pavarur, duhet t’i kushtohet vëmendje, ndër të tjera, mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatit të detyrë, ushtrimit të garancive ndaj presioneve të jashtme dhe çështjes nëse organi ka shprehjen e pavarësisë (shih, ndër të tjerash Morris v. Mbretërisë së Bashkuar nr 38784/97, § 58, KEDNJ 2002-I)”

Konkretisht në ligj 10447/2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,” është përcaktuar se Komisionet Eprore përbëhen nga 5 anëtarë

secili, të cilët zgjidhen në detyrë me vendim të Këshillit të Ministrave. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministri propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtar i pestë i Komisionit Epror propozohet nga Ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore. Nga ana tjetër janë parashikuar kriteret që duhet të kenë shtetasi shqiptar që mund të emërohet si anëtar i këtyre komisioneve.

Në dukje të para duket që ligji e realizon qëllimin për të cilin është hartuar, por nga një analizë e hollësishme e përmbajtjes e projektvendimit, konstatohet disa mangësi të cilat po ju parashtrijmë si më poshtë vijon:

Në pjesën I të këtij projektvendimit është përcaktuar se *“përbërja e Komisioneve Eprorë Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë,*



është sipas listës emërore që i bashkëlidhet këtij vendimi, në aneksin nr.1/1 të tij” po ti referohemi listës sipas aneksit bashkëlidhur projektvendimit i cili është pjesë integrale e tij, nuk parashikohet asnjë modalitet lidhur me mënyrën se si do të përzgjidhen kandidaturat që ministrat përkatës i propozojnë Këshillit të Ministrave si anëtarët të KMCP Epror.

Qëllimi i ligjbërësit në parashikimin e kriterëve ligjorë në përzgjedhjen e anëtarëve dëshmon hapur për faktin që ky proces (përzgjedhja)



duhet të udhëhiqet nga profesionalizmit. Por ky projektvendim i cili synon të normojë rregullimin dhe funksionimin e KMCA, lë ende të parregulluar mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar, që do të propozohen nga ana e ministrave të përkatës. Në këto kushte lipset si e domosdoshme që në përmbajtjen e projektevendimit të specifikohet në mënyrë të hollësishme procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, pasi në të kundërt, mungesa e këtyre rregullave mund të pasjellë cënimin e objektivitetit duke krijuar një hapësirë abuzimi nga ministrat

propozues, gjë që do të përçohet edhe te Këshillit të Ministrave si organ kolegjal i cili është ngarkuar për emërimin e tyre.

Për këtë arsye vlerësojmë si të nevojshme që pjesa I e këtij projektvendimi të riformulohet, duke saktësuar dhe përcaktuar se cilat kriterë do përbënin avantazh në përzgjedhjen e kandidatëve si dhe nga ana tjetër duke detajuar mënyrën e përzgjedhjes, e cila duhet të jetë e orientuar nga transparenca duke përfshirë elementët si njoftimi publik, parashikimin e afateve, procedurën e konkurimit etj.

Lidhur me përmbajtjen e pjesës II të projektvendimi konstatohet se kjo pjesë rregullon mënyrën e zhvillimit dhe organizimit të mbledhjes së KMCA, si organ kolegjal. Megjithatë me qëllim mirëfunksionimin e KMCA dhe përshtatjen e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij me kuadrin ligjor në fuqi, sugjerojmë që rregullat për thirrjen e mbledhjes, caktimin dhe njoftimin e rendit të ditës, mbledhjet e jashtëzakonshme, kuorumi i nevojshëm për mbledhje,

mënyrën e votimit si dhe kuorumin për nevojshëm për vendimarrje, duhet të jenë në përputhje të plotë me ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike". Nga ana tjetër sjellim në vëmendje, mundësinë që të shtohen në këtë pjesë shprehimisht edhe disa të drejta të aplikuesit, për të garantuar më mirë procesin e rregullt ligjor, konkretisht:

1. të drejtën e aplikuesit, për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij, afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
2. të drejtën e aplikuesit që të dëgjohet, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, dhe të drejtën për të paraqitur dëshmitarë;
3. të drejtën për tu informuar për datën se kur do të shqyrtohet seanca degjimore dhe se kur duhet të shpallet vendimi.

Ekspert të TLAS



STREET LAW TE ZHVILLUAR PER VITIN 2011

Projekti	RRETHET									Nr.total i publikimeve	Nr.total i perfitueseve
	Tirane	Durres	Elbasan	Fier	Lezhe	Shkoder	Korce	Vlore	Berat		
CRD	29.07.11 11.03.11			24.03.11 15.04.11 05.05.11 16.09.11 17.11.11 31.10.11 15.12.11					19.06.11 05.08.11 31.10.11	2400 Publikime	1211 Perfitues
UNICEF	25.01.11 28.02.11	23.03.11 25.03.11 19.04.11 28.11.11	16.03.11 30.05.11 22.04.11 26.01.11							2300 Publikime	1151 Perfitues
UNDP	09.11.11 20.09.11	28.09.11	10.11.11	16.09.11 17.10.11		18.11.11 19.11.11				2200 Publikime	1080 Perfituar
VAF	29.04.11 20.12.11					02.06.11 19.09.11 07.07.11	26.06.11 26.09.11	16.06.11 28.06.11 04.10.11 23.11.11		2200 Publikime	1100 Perfitues
EIDHR		14.01.11 10.01.11		12.04.11 18.05.11	23.02.11 19.06.11					1100 Publikime	540 Perfitues

Aktivitete STREET LAW











SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Rruga "Sami Frashëri"

4 kullat, Seksioni 3, Ap. 1A, Tirana, Albania

Tel/Fax: +355 4 2258 442

Tel: +355 4 2253 114

Kutia Postare 69

E-mail: tlas@tlas.org.al

www.tlas.org.al

TIRANA LEGAL AID SOCIETY

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 1 / 2012

TLAS

